



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: OE “SHANSI INVEST” sh.p.k. me NIPT J61924002T
Adresa: Tiranë, Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati 4, Shkalla 8,
Apartamenti 7.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” – me mjete elektronike – Mallra.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-81756-09-29-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Burrel”.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Data 09.10.2023, Nr. 84.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “SHANSI INVEST” sh.p.k. me NIPT J61924002T

Vlera 34,100,000 (tridhjetë e katër milion e njëqind mijë) Lekë pa TVSH.

2. OE “START CO” sh.p.k. me NIPT L11614001S

Vlera 34,779,000 (tridhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “START CO” sh.p.k., me NIPT L11614001S, për arsye se:

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi autorizimet e prodhuesit apo të distributorit të autorizuar të paraqitura nga OE ofertues janë në gjuhën

angleze, ndërkohe që në DST është kërkuar që çdo dokument të jetë në gjuhën shqipe, si dhe nuk është paraqitur autorizim prodhuesi për të gjithë artikujt sipas kërkesës.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur as dokumentacion dhe as deklaram në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që disponon punonjësit e kërkuar në këtë pikë.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi mallrat e ofruar nuk janë sipas kërkesës së Specifikimeve Teknike, konkretisht:

1. Në dokumentacionin e publikuar të tenderit kerkohen: detajet teknike të paisjeve hardware - **Monitore**: nga Operatori Ekonomik nuk është në dispozicion broshura apo dokumentacioni teknik.
2. Përsa i përket paisjes **Rack + KVM** nga Operatori Ekonomik nuk është në dispozicion broshura apo dokumentacioni teknik.
3. Përsa i përket pajisjes **Inverter DC-AC** nga Operatori Ekonomik nuk është paraqitur asnjë informacion rreth modelit që propozohet, mungon broshura apo dokumentacioni Teknik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “SHANSI INVEST” sh.p.k., me NIPT J61924002T** Adresa: Tiranë, Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **34,100,000 (tridhjetë e katër milion e njëqind mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO X

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova